




**SFIDAT  
DREJT  
INTEGRIMIT**



Konrad  
Adenauer  
Stiftung




Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Sfidat e Integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, zbatuar nga Qendra Europiane dhe mbështetur nga Fondacioni Konrad Adenauer, Zyra për Shqipërinë.

Përgatitën botimin:

MSc. Klara Kodra

MSc. Alba Brojka



Pikëpamjet e shprehura në këtë botim nuk shprehin qendrim zyrtar të Fondacionit Konrad Adenauer. ***Ato janë të gjitha nën përgjegjësinë juridike dhe profesionale të autorëve.***

© Qendra Europiane dhe Konrad-Adenauer-Stiftung

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë a mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, etj., pa lejen me shkrim të botuesve.


Për informacione ose komente mund të drejtoheni tek:

**Qendra Europiane**

Rr. “Vaso Pasha”  
P. 20, Ap. 57, 1001  
Tiranë, Shqipëri  
[www.euro-centre.eu](http://www.euro-centre.eu)

**Konrad-Adenauer-Stiftung**

Zyra për Shqipërinë  
Blv. “Dëshmorët e Kombit”  
Kulla Binjake 1, Kati 11, Zyra A3  
Tiranë, Shqipëri  
[www.kas.de](http://www.kas.de)



# Përmbajtja

## KAPITULLI 1 / PO BE-JA ÇFARË ËSHTË?

1.1 Çfarë është Bashkimi Evropian?	4
1.2 Ku dhe Si vepron BE-ja?	5
1.3 BE për qytetarët evropianë dhe për qytetarët e botës	6

## KAPITULLI 2 / INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN

2.1 Komisioni Evropian	7
2.2 Parlamenti Evropian	8
2.3 Këshilli Evropian	9
2.4 Këshilli i Bashkimit Evropian / Këshilli i Ministrave	10
2.5 Shërbimi i Jashtëm i BE-së	11
2.6 Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian	11
2.7 Banka Qendrore e BE-së	12

## KAPITULLI 3 / SFIDAT NË RRUGËN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

3.1 Instrumentat e Bashkimit Evropian për integrimin e Ballkanit Perëndimor	13
3.1.1 Instrumenta Politikë	13
3.1.2 Instrumenta Ekonomike	15
3.2 Bashkëpunimi rajonal me sfida të përbashkëta integrimi	16
3.3 Shqipëria dhe BE	17
3.4 Detyrat e shtëpisë së Shqipërisë për në Bashkimin Evropian	19
3.5 Pse ka rëndësi nota e mirë në detyrat e shtëpisë?	20

## KAPITULLI 4 / NJË HAP LARG BASHKIMIT EVROPIAN

4.1 Tridhjetë e pesë (35) Kapituj Detyrë Shtëpie	22
4.2 Çfarë janë Negociatat?	23
4.3 Detyra shtëpie kolektive për Ballkanin Perëndimor dhe detyra shtëpie individuale	26
4.4 A po i bëjmë detyrat e shtëpisë për kapitullin 23 dhe 24?	27

## KAPITULLI 5 / SHQIPTAR DHE EVROPIAN

5.1 Kontributi qytetar në jetën e përditshme në procesin e integrimit	30
---	----



## KAPITULLI 1

### 4

# PO BE-JA ÇFARË ËSHTË?

Sfidat Drejt Integritimit

## 1.1 Çfarë është Bashkimi Evropian?

Bashkimi Evropian është një **organizatë ndërkombëtare me status të veçantë**. Nuk është një shtet federal si SHBA dhe as një organizatë ndërkombëtare si OKB-ja. Shtetet anëtare të saj përcaktojnë hapësirën dhe kompetencat e BE-së për të vepruar. Në 1952 BE-ja nisi si një organizatë me qëllim politikash ekonomike të përbashkëta mes 6 shteteve. Më pas ajo u zgjerua me shtete të tjera dhe bashkëpunimi ekonomik përfshiu dhe fushat politike. Aktualisht BE-ja është e përbërë nga 28 shtete anëtare. Nga 2019 Bashkimi do të ketë 27 shtete anëtare, pas largimit të Britanisë së Madhe.

**Më tepër sesa thjesht një organizatë, BE-ja është një bashkim njerëzish, idesh dhe vlerash.** Prej 70 vitesh kontinenti Evropian jeton në harmoni dhe paqe, ku bazë e marrëdhënieve midis shteteve është dialogu dhe jo konflikti.

## 1.2 Ku dhe Si vepron BE-ja?

Kompetencat e Bashkimit Evropian apo siç mund t'i quajmë ndryshe edhe fushat në të cilat Unioni mund të veprojë, duke vendosur ligje apo hartuar politika, është e përcaktuar në bashkëpunim me shtetet anëtare të tij. Shtetet anëtare kanë hequr dorë nga ushtrimi i disa detyrave dhe të drejtave në disa fusha specifike, duke ja kaluar këto “të drejta” BE-së.

Bashkimi Evropian ka kaluar në disa faza zgjerimi të fushave të bashkëpunimit.

- **Komuniteti i Hekurit dhe Çelikut** – u themelua në vitin 1952;
- **Komuniteti Ekonomik Evropian dhe Komuniteti Evropian i Energjisë dhe Atomiumit** e pasoi në 1958;
- **Traktati i Mاستrihtit** – i hyrë në fuqi në 1993 zgjeroi kompetencat e BE-së duke i vendosur në tre shtylla kryesore;
- **Traktati i Amsterdimit** (1997) dhe **Traktati i Nisës** (2001) që zgjeruan më tej hapësirën e veprimit të Komisionit Evropian dhe Traktati më i fundit, i **Lisbonës** (2009) që bëri ndarjen e kompetencave siç përshkruhen më poshtë.

Hapësira e veprimit të BE-së për të ndërmarrë politika në këto fusha ndahet në tre kategori.

**1. Kategoria e kompetencave ekskluzive:** janë fusha veprimi ku vendos dhe ushtron politik-bërjen vetëm BE-ja. (Neni 3 i Traktatit për Funkzionimin e Bashkimit Evropian (TFBE)) Këto kategori përfshijnë doganat, rregullat e konkurrencës për tregun e përbashkët evropian, politikën e përbashkët tregtare, ruajtjen e burimeve detare dhe politikën e përbashkët të peshkimit, si edhe politikën e përbashkët monetare për shtetet e eurozonës. Në këto fusha BE vepron e vetme dhe është përgjegjëse për suksesin ose dështimin e këtyre politikave.

**2. Kompetencat e ndara me shtetet anëtare:** këto janë fusha ku BE ndërmerr politika së bashku me shtetet anëtare. (Neni 4 i TFBE) Këtu përfshihet: tregu i brendshëm Evropian; politikat sociale; politikat ekonomike dhe sociale të kohezionit; mjedisi; mbrojtja e konsumatorit; transporti; energjia; bujqësia dhe peshkimi; çështjet e sigurisë së shëndetit; dhe punët e brendshme që lidhen me drejtësinë dhe sigurinë. Në kompetencat e ndara,

BE vepron ne bashkërendim me institucionet dhe shtetet anëtare, ku çdo politikë apo vendim duhet të konsultohet së brendshmi.

**3. Kompetencat mbështetëse për shtetet anëtare:** janë fusha veprimi ku BE vepron vetëm në mbështetje të shteteve anëtare te saj, nëse këto të fundit nuk mund të arrijnë rezultatet e pritshme duke vepruar vetë. (Neni 6 i TFBE) Këto kompetenca përfshijnë: mbrojtjen e shëndetit të njerëzve; industrinë; kulturën; turizmin; edukimin, rininë dhe sportet; mbrojtjen e qytetarëve dhe bashkëpunimin administrativ. BE në këtë kategori vepron vetëm duke mbushur hapësirat ose mungesat e shteteve anëtare të saj, e për pasojë dhe veprimtaria apo hartimi i politikave të unifikuar për të tërë hapësirën e BE-së në këto fusha është shumë e kufizuar.

### 1.3 BE për qytetarët evropianë dhe për qytetarët e botës

BE për qytetarët evropianë është një bashkësi vlerash, një hapësirë e përbashkët ekonomike dhe politike, ku të gjithë njerëzit gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyra si edhe standarde jetese. Bashkimi Evropian kujdeset që shtetet anëtare t'u sigurojnë qytetarëve të tyre një demokraci të qëndrueshme, barazi, liri dhe të drejta. BE-ja gjithashtu siguron për qytetarët e saj standarde më të mira të jetës, të punës, të ushqimit, të shërbimit shëndetësor, të edukimit etj. Të gjithë qytetarët kanë të drejtën të lëvizin në hapësirën e përbashkët të shteteve anëtare për punë, edukim ose jetesë, të tregtojnë mallra, të ndërtojnë biznese dhe të ofrojnë shërbime. Këto njihen ndryshe edhe si katër lëvizjet brenda Bashkimit Evropian.

Ndërsa për qytetarët e botës, BE shërben si një nxitës i reformave të shteteve drejt integritit (si rasti i Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit); nxitjes së demokracisë nëpërmjet ofrimit të mbështetjes financiare dhe teknike për institucionet; nxitjes së barazisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut kudo në botë; jep fonde dhe krijon mundësi shkëmbimi për studentët; ofron tregti dhe nxit ekonominë e vendeve në zhvillim; ofron ndihmë ekonomike për shtetet në luftë apo që sapo kanë dalë nga lufta; nxit përmirësimin e standardeve të jetës dhe shëndetit në vendet që duan të integrohen në BE etj. Gjithashtu, Bashkimi Evropian bashkëpunon me shtetet në botë që këto të ofrojnë shërbime më të mira për qytetarët e tyre, si p.sh., rindërtimi i shkollave, i kanalizimeve të ujit të pijshëm, përmirësimi të cilësisë së edukimit dhe kërkimit shkencor etj.



## KAPITULLI 2

# INSTITUCIONET E BASHKIMIT EVROPIAN

7

Sfidat Drejt Integritimit

### 2.1 Komisioni Evropian

Komisioni Evropian është një nga tre institucionet kryesore të BE, i cili përbëhet nga 28 komisionerë. Çdo shtet anëtar i Bashkimit Evropian përfaqësohet nga një komisioner, i propozuar nga Këshilli dhe i miratuar nga Parlamenti Evropian. Gjithashtu, Komisioni Evropian kryesohet nga Presidenti, i cili propozohet nga Këshilli i Evropës dhe zgjidhet nga Parlamenti Evropian me një mandat 5 vjeçar. Komisionerët nuk përfaqësojnë pikëpamjet e shteteve të tyre të origjinës, por interesin e përbashkët të Bashkimit Evropian. Çdo anëtar i Komisionit përgjigjet për një fushë të caktuar, si psh: ekonomia, tregëtia, energjia, etj.

Komisioni Evropian është **organi ekzekutiv** i Bashkimit Evropian.

## Funksionet e Komisionit:

### 1. **Menaxhimi i buxhetit**

Ai menaxhon dhe harton politikat dhe buxhetin e BE-së, si edhe sigurohet që shtetet anëtare po zbatojnë në mënyrën e duhur legjislacionin e Bashkimit Evropian.

### 2. **Propozimi i ligjeve të reja**

Komisioni **propozon ligje** dhe programe të reja, në interes të BE-së. Përpara hartimit së një propozimi, Komisioni merr mendimin e parlamenteve kombëtare, qeverive, grupeve të interesit dhe ekspertëve si dhe të publikut në tërësi, të cilët ftohen të bëjnë komentet e tyre online. Propozimet e Komisionit shqyrtohen nga Parlamenti Evropian dhe Këshilli.

### 3. **Zbatimi i ligjit të BE (në bashkëpunim me Gjykatën e Drejtësisë)**

Në rast se një shtet anëtar nuk zbaton rregullat dhe Direktivat e BE-së atëherë Komisioni i drejton letër zyrtare me qëllim marrjen e masave të domosdoshme nga ana e shtetit që ka kryer shkeljen. Për këtë arsye Komisioni Evropian njihet si “roje i së drejtës evropiane”.

**Presidenti i Komisionit**  
**Jean Claude Juncker**



**Selia e tij**  
**Bruksel & Luksemburg**

## 2.2 Parlamenti Evropian

Parlamenti Evropian është zëri i qytetarëve të BE. 751 anëtarët e tij përfaqësojnë qytetarët e 28 shteteve. Eurodeputetët zgjidhen drejtpërdrejt nga qytetarët çdo 5 vjet. Zgjedhjet e ardhshme për Parlamentin do të mbahen pranverën e vitit 2019. Kushdo ka të drejtë të votojë pasi ka mbushur moshën e përcaktuar në ligj për të ushtruar këtë të drejtë.

Numri i anëtarëve përfaqësues të çdo shteti zgjidhjet në bazë të popullsisë së shtetit p.sh., Gjermania 96 eurodeputetë pasi ka 82.67 milionë banorë, ndërsa Estonia ka 6 eurodeputetë pasi ka 1.3 milionë banorë. Anëtarët e PE ndahen në grupe pune sipas bindjeve politike dhe jo në bazë të shtetësisë së tyre. Një grup politik përbëhet nga 25 anëtarë me përfaqësues nga të paktën  $\frac{1}{4}$  e shteteve të BE. Aktualisht PE përbëhet nga 8 grupe.





Parlamenti merr vendime **mbi legjislacionin** në bashkëpunim me Këshillin dhe nëse ato nuk bien dakort së bashku, ligji nuk miratohet. Ndër funksionet e Parlamentit mund të përmendim dhe zgjedhjen e Presidentit dhe 28 anëtarëve të Komisionit Evropian si dhe miratimin e buxhetit të Bashkimit Evropian.

*Presidenti i Parlamentit Evropian*  
**Antonio Tajani**



*Selia e tij*  
**Bruksel & Strasburg**

## **2.3** Këshilli Evropian

Këshilli Evropian është pjesë e rëndësishme e Evropës. Ky institucion e ka filluar veprimtarinë e tij në 1974, si një forum ku diskutonin liderat e shteteve anëtare të Evropës. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli Evropian u bë zyrtarisht një nga institucionet e BE-së. Këshilli bën bashkë presidentët ose kryeministrat e vendeve të Bashkimit Evropian. Ata mbledhen të paktën 4 herë në vit dhe këto mbledhje quhen ndryshe “Samite Evropiane”. Këshilli Evropian vendos prioritetet kryesore dhe direktivat e përgjithshme politike për Bashkimin Evropian. Ai drejtohet nga Presidenti, i cili zgjidhet me një mandat 2.5 vjeçar.

Presidenca e Këshillit Evropian është përgjegjëse për funksionimin e këtij institucioni. Kryesia e Këshillit të BE ndërrohet me rotacion çdo 6 muaj dhe përfaqësuesi nuk është një individ i vetëm, por një qeveri kombëtare. Funksioni

i presidencës është të kryesojë mbledhjet e Këshillit, të përcaktojë axhendat e tij, të vendosë një program pune dhe të lehtësojë dialogun si në mbledhjet e Këshillit dhe në institucionet e tjera të BE-së. Nga janari 2018, Presidencën e Këshillit Evropian e mban Bullgaria.

*Presidenti i Këshillit Evropian*  
**Donald Tusk**



*Selia e tij*  
**Bruksel**

Treshja 2017-2018 e presidencës është:

- ▶ Estonia (Korrik-Dhjetor 2017)
- ▶ **Presidenca - Bullgaria (Janar-Qershor 2018)**
- ▶ Austria (Korrik-Dhjetor 2018)

## **2.4** Këshilli i Bashkimit Evropian / Këshilli i Ministrave

Këshilli i Bashkimit Evropian, ndryshe i njohur si Këshilli i Ministrave është organi kryesor vendimmarrës i Bashkimit Evropian. Ai përfaqëson shtetet anëtare dhe në takimet e tij merr pjesë një ministër nga secila prej qeverive të shteteve anëtare në varësi të natyrës së çështjeve, që do të diskutohen në takim.

Secili prej ministrave në Këshill gëzon të drejta të plota, që do të thotë se deklaratat dhe veprimet e tij përfaqësojnë qeverinë e shtetit të tij. Gjithashtu, çdo ministër i Këshillit është përgjegjës ndaj Parlamentit të vendit të tij si dhe ndaj qytetareve, duke garantuar kështu legjitimitetin e vendimeve të Këshillit.

Këshilli ushtron 6 funksione kryesore:

1. Miraton legjislacionin e BE-së;
2. Bashkëtrendimi i politikave ekonomike;
3. Nënshkrimi i marrëveshjeve ndërkombëtare, në emër të Bashkimit Evropian, me shtete ose organizata ndërkombëtare;
4. Miraton buxhetin e BE-së së bashku me Parlamentin Evropian;
5. Përmirësimi i Politikave të Jashtme dhe të Sigurisë së Përbashkët të BE-së;
6. Koordinon bashkëpunimin mes gjykatave dhe forcave të rendit të shteteve për çështjet penale.

## 2.5 Shërbimi i Jashtëm i BE-së

Shërbimi i Jashtëm i BE-së ndryshe njihet si shërbimi diplomatik përfaqëson organizatën dhe qytetarët e saj në të gjithë botën. Shërbimi i Jashtëm i BE-së përbëhet nga nëpunës të BE, nëpunës dhe diplomatë të shteteve anëtare, si edhe nga nëpunës nga e gjithë bota si shërbime delegacionesh si p.sh., Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri. Funkzioni kryesor i këtij Shërbimi është të ndërtojë dhe përfaqësojë politikën e jashtme të BE-së në të gjitha kontinentet për çështje si: të drejtat e njeriut, migrimi, zhvillimi i demokracisë, çështjet e sigurisë apo edhe çështjet ushtarake. Në krye të Shërbimit të Jashtëm të BE-së qëndron Përfaqesuesi/ja e lartë që mban edhe titullin e Zv. Presidentit/es të Komisionit Evropian.

*Përfaqësuesja e Politikës së  
Jashtme dhe Sigurisë së BE-së:*  
**Federica Mogherini**



## 2.6 Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian është Gjykata më e Lartë e BE-së. Ajo vepron si Gjykatë ndërkombëtare dhe si Gjykatë e brendshme e shteteve anëtare. Detyra e saj është të garantojë që e Drejta e BE-së interpretohet dhe zbatohet në mënyrë uniforme në të gjitha shtetet anëtare. Gjykata Evropiane përbëhet nga 28 anëtarë (gjyqtarë) dhe 8 avokatë të përgjithshëm, të cilët kanë për detyrë të japin opinione ligjore për çështjet që shtrohen për zgjidhje para gjykatës. Mendimet e tyre jepen publikisht dhe duhet të jenë të paanshme. Gjykatë funksionon si në rastet kur një gjykatë vendase ka dyshime për interpretimin e ligjeve të BE-së, ashtu dhe kur një shtet anëtar i BE-së nuk i zbaton ligjet në mënyrë të rregullt.

*Kryetari i GJED*  
**Koen Lenaerts**



*Selia e Gjykatës*  
**Luksemburg**



## 2.7 Banka Qendrore e BE-së

Banka Qendrore Evropiane është institucioni që ka në ngarkim politikën monetare për 17 vendet e Bashkimit Evropian, që përdorin monedhën euro dhe formojnë të ashtuquajturën “Eurozonë”. Qëllimi kryesor i Bankës është garantimi i stabilitetit të çmimeve në eurozonë. Detyrat qendrore janë përcaktimi dhe zbatimi i politikës monetare në shtetet e Bashkimit Monetar Evropian (BME), administrimi i rezervave valutore zyrtare, mbështetja e sistemit të pagesave dhe zbatimi i transaksioneve valutore. BQE ka gjithashtu të drejtën ekskluzive për emetimin e bankënotave euro në BME. Sipas Marrëveshjes së Mاستrihit, BQE është e pavarur nga çdo ndikim politik. Banka disponon buxhet prej pesë miliardë eurosh, i cili jepet nga bankat qendrore të 17 vendeve të eurozonës të BE-së. Republika Federale e Gjermanisë ka pjesën më të madhe në këtë buxhet.

**Presidenti i BQE**  
**Mario Draghi**



**Selia**  
**Frankfurt**

# SFIDAT NË RRUGËN E INTEGRIMIT NË BASHKIMIN EVROPIAN

## 3.1 Instrumentat e Bashkimit Evropian për integrimin e Ballkanit Perëndimor

### 3.1.1 Instrumenta Politikë

**Pakti i Stabilitetit:** Bashkëpunimi BE - Ballkan u thellua si fillim në vitin 1999, në kohën e luftës në Kosovë. Për herë të parë, Bashkimi Evropian ndërtoi një instrument për vendosjen e lidhjeve të ngushta me Ballkanin nëpërmjet Paktit të Stabilitetit, i cili merrej me çështjen e sigurisë edhe stabilitetit në Ballkan. Për herë të parë rajoni u pa si pjesë e Evropës me mundësi për anëtarësim.

**Procesi i Stabilizim Asociimit (PSA):** Më shumë sesa një instrument është një politikë. Ky Proces nisi gjithashtu në 1999 dhe vendosi marrëdhënie individuale mes BE-së dhe çdo shteti të rajonit të Ballkanit. Procesi i Stabilizim Asociimit përmban hapa dhe kushte për përmirësimin e situatës politike të shtetit drejt **demokracisë** dhe **shtetit të së drejtës**, si edhe vendos lidhjet e para mes ekonomisë së shtetit dhe tregut të përbashkët Evropian. Pësha më e madhe e tij i takon faktorit politik ku qeveria është përgjegjëse kryesore për mirëfunksionimin e procesit në identifikimin e objektivave të përbashkëta me BE-në dhe pasjen e marrëdhënieve të mira fqinjësore në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Procesi i Stabilizim Asociimit mbështet nga ana financiare nga fondet IPA. PSA vazhdon derisa vendi bëhet anëtar i BE-së.

**Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA):** është instrumenti kryesor që rregullon **marrëdhëniet** mes **Bashkimit Evropian** dhe **vendeve** që duan të anëtarësohen. Kjo Marrëveshje është në zbatim të Procesit të Stabilizim Asociimit dhe synon së pari të zhvillojë një treg të lirë mes BE-së dhe shtetit që firmoset marrëveshja. Pasi ky rregullim për tregtinë e lirë të mallrave është bërë dhe mallrat vendase shiten në BE dhe ato të BE-së brenda vendit, Marrëveshja identifikon **objektiva politike** dhe **ekonomike** të përbashkëta.

**Progres raportet:** janë një instrument kyç i marrëdhënieve BE - shteti që kërkon të anëtarësohet. Këto raporte janë vjetore dhe masin punën dhe përmirësimin e vendeve sipas tre kritereve kryesore: (i) **kriteri politik** ku vëmendje i kushtohet forcimit të shtetit të së drejtës, gjykatave të pavarura, lirisë së medias, respektimit të të drejtave të njeriut etj. (ii) **kriteri ekonomik**, ku raportohet mbi gjendjen e zhvillimit të tregut të lirë mes BE-së dhe shtetit për të cilin hartohet raporti, zhvillimit të konkurrencës në treg, gjendja dhe niveli i papunësisë, rritja e standardeve të produkteve etj. (iii) **kriteri ligjor:** ky kriter ka të bëjë me aftësinë që ka shteti që kërkon të anëtarësohet të përthithë dhe të marrë ligjet dhe rregulloret e Bashkimit Evropian në legjislacionin e brendshëm. Kriteri ligjor është një kusht i fortë dhe strikt që tregon sesa i gatshëm është vendi të qeveriset sipas ligjeve të BE-së dhe sesa gati është administrata e atij vendi t'i zbatojë në punën e përditshme këto ligje. Këto kritere janë të njohura ndryshe edhe si **Kriteret e Kopenhagenit** dhe përbëjnë kushtet kryesore të anëtarësimit.

**Dialogjet bilaterale:** janë një formë tjetër e marrëdhënieve BE dhe shteteve të rajonit. Këto marrëdhënie janë mes Bashkimit Evropian dhe një shteti të rajonit të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri, Maqedoni, Mal i Zi, Kosovë). Dialogjet marrin formën e takimeve mes kryetarëve të institucioneve të BE-së ose shteteve anëtare të BE-së dhe kryeministrit ose ministrave të vendit që kërkon të anëtarësohet.

**Strategjitë e zgjerimit:** janë gjithashtu një instrument politik i Bashkimit Evropian që hartohet çdo vit nga Komisioni Evropian. Strategjia përcakton linjën dhe objektivat kryesore të BE-së për vendet që duan të anëtarësohen. Këto strategji tregojnë mbi të gjitha gadishmërinë dhe nivelin e optimizmit të BE-së për të ndërmarrë politika zgjerimi në shtete të reja. Strategjitë kanë dy pjesë kryesore: **politike** dhe **ekonomike** e në fund përmbajnë konkluz-

ione dhe përmbledhje të raporteve për secilin shtet. Vihet re që Komisioni i ka dhënë më shumë rëndësi kriterit politik për shtetin demokratik dhe të drejtat e njeriut, duke i vendosur ato në pjesën e parë të raportit. Strategjia e Zgjerimit më e fundit ishte e 2018. Kjo Strategji ishte mjaft pozitive dhe përcaktonte në mënyrë konkrete hapat për secilin vend për t'u anëtarësuar. Gjithashtu, ajo parashikonte më shumë bashkëpunim të ndërsjelltë mes agjencive dhe institucioneve të BE-së me ato të Ballkanit si edhe më shumë mundësi për fonde për rajonin.

**Negociatat:** janë instrument politik i marrëdhënieve BE - shtet kandidat. Në këtë fazë shteti që kërkon të anëtarësohet ka bërë përmirësime të vazhdueshme e të dukshme, duke marrë statusin vend kandidat për në BE dhe duke hapur negociatat për anëtarësim. Më shumë për negociatat do të flitet në kapitullin pasardhës.

### 3.1.2 Instrumenta ekonomike

**MSA dhe Fondet IPA:** MSA përcakton objektivat dhe politikat kryesore për ekonominë dhe mbështetet nga ana financiare nëpërmjet fondeve IPA. Këto fonde jepen nga Bashkimi Evropian për vendet para anëtarësimit në mënyrë që këto të kenë fonde për të bërë reformat dhe për të përmirësuar shërbimet. Këto fonde janë të ndara në dy kategori. Fonde për një shtet të caktuar dhe fondet ndërkufitare, të cilat financojnë projekte ndërlidhjeje në rajon si p.sh., rrugë, hidrocentrale etj.

**Programet e Reformave Ekonomike (PRE)** ose të njohura ndryshe në anglisht ERP, janë instrumentat më të reja të integrimit në fushën ekonomike. Këto Programe janë raporte ekonomike që secili vend i Ballkanit Perëndimor i dërgon Komisionit Evropian për t'i shpjeguar gjendjen ekonomike të shtetit. Ato u aplikuan për herë të parë në vitin 2015 dhe do vazhdojnë të hartohen çdo vit deri në fazën e integrimit. Qëllimi i PRE është të identifikojë problemet e ekonomisë së secilit shtet në mënyrë që BE të hartojë politika ekonomike dhe të japë fonde për vendin, sipas nevojave të tij.

**Marrëveshja e Tregtisë së Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA),** është një instrument ekonomik dhe teknik mes BE-së dhe vendeve jo anëtare si për shembull vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor. CEFTA synon zhvillimin e

një tregu të lirë nëpërmjet Marrëveshjeve të Tregut të Lirë me secilin shtet, qoftë ky shtet që kërkon të anëtarësohet në BE ose jo.

### **3.2** Bashkëpunimi rajonal me sfida të përbashkëta integrimi

Ballkani Perëndimor karakterizohet nga sfida të përbashkëta në procesin e integrimit në BE. Këto sfida kanë tipare të ngjashme jo vetëm brenda Ballkanit, por edhe në rajonin e Evropës Qendrore e Lindore. Të gjitha këto vende kanë qenë pjesë e ish bllokut komunist, e për pasojë kanë mangësi në institucione të forta demokratike dhe ekonomi me treg të hapur e konkurrues. Me anëtarësimin e vendeve të Evropës Qendrore e Lindore në 2004, anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë në 2007 si edhe të Kroacisë në 2013, vendet e Ballkanit tashmë kanë shembuj se kushtet dhe nxitja e BE-së në reformimin e këtyre shteteve funksionon.

Gjithashtu 6 vendet e Ballkanit karakterizohen nga faktorë historikë e gjeografikë të njëjtë dhe me konflikte me tipare identiteti. Disa nga problemet kryesore të ngjashme në secilin vend të rajonit të Ballkanit Perëndimor që kërkon të anëtarësohet janë:

- ★ Forcimi i demokracisë;
- ★ Përmirësimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe të minoriteteve;
- ★ Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;
- ★ Forcimi i institucioneve dhe administratës publike;
- ★ Zhvillimi i gjykatave të pavarura e të drejta;
- ★ Zhvillimi i një tregu të hapur;
- ★ Rritja e konkurrencës së tregut dhe ekonomisë;
- ★ Ulja e papunësisë;
- ★ Rritja ekonomike;
- ★ Zhvillimi i infrastrukturës së rrugëve dhe rrjetit energjitik;
- ★ Përmirësimi i politikave për të rinjtë;
- ★ Përmirësimi i cilësisë së edukimit dhe kërkimit shkencor;
- ★ Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe bashkëpunimi rajonal.



Për këtë arsye, BE-ja dhe Komisioni Evropian që prej vitit 2014, nxisin fuqishëm vendet e rajonit të bashkëpunojnë në sfidat e përbashkëta. Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore përbëjnë gjithashtu një kusht thelbësor në Procesin e Stabilizim Asociimit dhe në anëtarësimin e këtyre vendeve.

### 3.3 Shqipëria dhe BE

- |                     |  |
|---------------------|--|
| <b>1991</b>         | Vendosen marrëdhëniet diplomatike Shqipëri-BE.   |
| <b>1992</b>         | Nënshkrimi i Marrëveshjes së Bashkëpunimit Tregtar dhe Ekonomik mes Shqipërisë dhe BE-së.  |
| <b>1997</b>         | Përqasja Rajonale për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi Shqipërinë, ku vendet duhet të plotësonin kushtet politike dhe ekonomike. |
| <b>1999</b>         | Bashkimi Evropian propozon Procesin e Stabilizim-Asociimit për vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshi Shqipërinë.                      |
| <b>Qershor 2000</b> | Vendet e Ballkanit Perëndimor janë kandidatet potenciale për anëtarësim në BE, përfshi Shqipërinë.                                     |
| <b>Nëntor 2000</b>  | Fillimi i Procesit të Stabilizim-Asociimit mes BE dhe Shqipërisë.  |
| <b>Janar 2003</b>   | Hapen negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit Shqipëri-BE.  |
| <b>Shkurt 2006</b>  | Mbyllet negociatat për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit.  |
| <b>2003</b>         | Këshilli Evropian i Selanikut, mbështeti të ardhmen e rajonit si një pjesë integrale e BE-së.  |

- 
- Maj 2006** Hyn në fuqi Marrëveshja e Ripranimit BE-Shqipëri.
- 
- Qershor 2006** Nënshkruhet Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.
- 
- Janar 2007** Hyn në fuqi instrumenti i ri i paraaderimit.
- 
- Janar 2008** Hyn në fuqi marrëveshja e lehtësimit të vizave mes Shqipërisë dhe BE-së.
- 
- Prill 2009** Hyn në fuqi Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri.
- 
- Prill 2009** Shqipëria paraqet kërkesën zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
- 
- Nëntor 2010** BE miraton vendimin për liberalizimin e vizave me Shqipërinë.
- 
- Dhjetor 2010** Hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vendet e zonës Schengen.
- 
- Dhjetor 2011** Plani i Punës për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, plotësimi i rekomandimeve.
- 
- Tetor 2012** Komisioni Evropian rekomandon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.
- 
- Dhjetor 2013** BE refuzon dhënien e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë.
- 
- Qershor 2014** Shqipëria merr statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
- 
- Prill 2018** Rekomandim pa kushte për hapjen e negociatave.

### 3.4 Detyrat e shtëpisë së Shqipërisë për në Bashkimin Evropian

Shpeshherë, media, politikanët, apo njerëz të ndryshëm i shikojnë kushtet e Bashkimit Evropian si detyra shtëpie. Në fakt, më shumë se detyra, kushtet janë masa të cilat përmirësojnë funksionimin e një shteti demokratik dhe u sigurojnë qytetarëve një jetë më të mirë nga ana ekonomike. Si një matës i këtyre masave, Komisioni Evropian publikon raporte vjetore për shtetet duke e matur përmirësimin sipas kushteve të Kopenhagenit. Prej 2014, vit kur vendi mori statusin e vendit kandidat, kanë shërbyer si busull për të përcaktuar fushat ku Shqipëria duhet të përmirësohet.

Nga viti 2014, Komisioni Evropian përcakton fushat ku ndryshimi dhe përmirësimi është i nevojshëm të bëhet më shpejt. Këto fusha janë: reforma në administratën publike; lufta kundër korrupsionit; lufta kundër krimit të organizuar; pavarësia e gjykatave; si dhe respektimi i të drejtave themelore të njeriut. Nga Progres Raportet e çdo viti është vërejtur:

- » Reforma në administratën publike që synon të zhvillojë institucione pa ndikimin e politikës, ka patur përmirësime nga 2014 në 2015 dhe përmirësimi ka qenë njëlloj deri në 2016.
- » Lufta kundër korrupsionit në çdo nivel të qeverisjes dhe institucioneve shtetërore ka patur pak progres nga 2014 në 2016.
- » Lufta kundër krimit të organizuar, ku futet lufta kundër kultivimit të drogës, trafikimi i drogës dhe pastrimi i parave, ka patur pak progres nga 2014 në 2016. Progresi më i madh i vlerësuar nga Brukseli ishte ndërhyrja dhe konfiskimi i drogës që u krye në Lazarat.
- » Pavarësia e gjykatave, ku përfshihen gjyqtarët e pavarur, të pakorruptuar, dhe zgjidhja e problemeve të qytetarëve në mënyrë korrekte dhe të shpejtë, ka patur gjithashtu pak progres nga 2014 në 2016. Megjithatë, Komisioni Evropian është pozitiv se Shqipëria është në rrugën e duhur për të përmirësuar pavarësinë e gjykatave me adoptimin e reformës në drejtësi në 2016. Kjo reformë synon të bëjë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me pastërtinë e figurës së tyre, duke larguar nga sistemi gjyqtarët e korruptuar, që i shërbejnë interesave politike.

- » Respektimi i të drejtave themelore vlerësohet si me pak progres nga 2014 në 2015 dhe me progres më të mirë nga 2015 në 2016. Megjithatë raporti thekson se edhe pse Shqipëria ka miratuar shumë ligje me të njëjtat nivele të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, zbatimi i këtyre ligjeve në jetën e përditshme mbetet një sfidë. Garantimi i të drejtave të njeriut nuk duhet të jetë vetëm në letër, por edhe në punën e përditshme të shtetit, thekson Progres Raporti i 2016 për Shqipërinë.

Përmirësimi i punës së qeverisë, parlamentit dhe gjykatave në këto pesë prioritetë të përcaktuara nga Komisioni Evropian, përkthehet menjëherë në hapjen e negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian. Megjithatë, duhet garantuar që është bërë punë mjaftueshëm në secilin prej prioritetëve dhe që qytetarët e ndiejnë përmirësimin e ardhur nga zbatimi i tyre.

### 3.5 Pse ka rëndësi nota e mirë në detyrat e shtëpisë?

Përbushja e kriterëve të Kopenhagenit të përmendura më lart, si edhe kushteve që Bashkimi Evropian vë për secilin shtet në bazë të nevojave specifike për t'u reformuar, shihen vazhdimisht si një detyrë shtëpie nga Brukseli që qeveria duhet të përbushë në mënyrë që shteti të anëtarësohet në BE.

Ky përshkrim çon në përfundime të gabuara, pasi kushtet që Bashkimi Evropian vë mbi shtetet, nuk kanë gjë tjetër veçse mekanizma që shtetet të cilat kanë patur një histori politike të vështirë, të ndërmarrin reforma dhe të përqafojnë demokracinë dhe vlerat Evropiane. Kështu, këto vlera që respektohen nga shtetet anëtare të BE-së, si të drejtat e njeriut, mungesa e korrupsionit, investimi në art dhe edukim, gjykata të pavarura dhe deputetë që përfaqësojnë popullin, duhet të kuptohen dhe zbatohen edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor përpara se ato të futen në BE. Bashkimi Evropian synon që nëpërmjet fondeve dhe presionit që ushtron me kushtet, të nxisë qeveritë dhe politikanët të bëjnë reforma që forcojnë institucionet demokratike, të cilat në kohën e komunizmit, nuk ekzistonin fare.

Në këtë mënyrë, kushtet do të ishte e drejtë të quheshin detyra drejt një shteti demokratik ku përfituesit më të mëdhenj janë qytetarët e atij shte-

ti. Në një shtet demokratik, ekziston liria e shprehjes, qytetarët kanë mjete ankimi, mund të shkojnë në gjykata dhe të mbrojnë të drejtat e tyre, të krijojnë një biznes dhe të mos jenë në konkurrencë me biznese që në mënyrë të padrejtë përkrahen nga politika, të përfitojnë nga shërbime shëndetësore dhe edukimi pa korrupsion etj. Këto janë tipare të shtetit demokratik që Bashkimi Evropian kërkon të arrijë edhe në shtetet e Ballkanit Perëndimor nëpërmjet kushteve për anëtarësim. Nëse reformat kanë rezultat, ato përthehen si shërbime më të mira për shtetasit, edukim më cilësor, shërbim shëndetësor më i mirë, shërbim administrativ më i shpejtë dhe më i hapur për qytetarët, etj.

Më konkretisht, pas reformës në administratën publike në Shqipëri, institucionet shqiptare duhet të funksionojnë si një aparat që vë në zbatim ligjet dhe jep shërbime për qytetarët shqiptarë. Administrata nuk duhet të shihet më si një vend ku partitë politike ndërrojnë punonjësit dhe vënë në punë ata që i përkrahen politikisht. Reformë e suksesshme në administratën publike do të thotë që ajo të mbushet me persona që e meritojnë vendin e punës në mënyrë të drejtë dhe jo nëpërmjet njohjeve, janë profesionistë, dhe i shërbejnë shtetit dhe qytetarëve e jo partive politike.

Ndërsa reforma më e fundit në drejtësi, është një reformë e rrallë, por e domosdoshme që një ndër pushtetet më të rëndësishme të një shteti demokratik të funksionojë. Gjykatat duhet të jenë vendet ku jepet drejtësi, ku nuk mbrohen personat e korruptuar, ku gjykatësi/sja është i/e respektuar për punën e tij/saj për të dhënë vendime të drejta dhe zgjidhur problemet mes njerëzve, apo mes njerëzve dhe shtetit. Ndaj është e rëndësishme që populli t'i kërkojë dhe t'i mbështesë reformat, pasi i shërbejnë atij vetë dhe jo thjesht përmbushjes së kriteve të Brukselit.

## NJË HAP LARG DREJT BASHKIMIT EVROPIAN

### 4.1 Tridhjetë e pesë (35) Kapituj Detyrë Shtëpie

Me qëllim që shteti ynë t`i bashkohet Bashkimit Evropian duhet të respektojë vlerat demokratike të tij dhe të angazhohet në promovimin e tyre. Përveç respektimit të vlerave, duhen përmbushur Kriteret e Kopenhagenit, të cilat janë:

- ▶ **Kriteri Politik**
- ▶ **Kriteri Ekonomik**
- ▶ **Kriteri Ligjor dhe Administrativ**

Nga marrja e statusit kandidat deri më sot ne jemi në pritje për hapjen e negociatave për anëtarësim. Negociatat kanë të bëjnë me miratimin dhe vënien në zbatim të gjithë *acquis* të BE-së, të cilat ndahen në **35 kapituj**, ku ecuria e çdo kapitulli monitorohet dhe vlerësohet nga Komisioni Evropian. Secili prej kapitujve diskutohet më vete dhe në bazë të situatës apo ecurisë mund të përcaktohen kriteret/standarde të matshme për hapjen dhe mbylljen e secilit prej kapitujve. Këshilli së bashku me vendin kandidat analizojnë ligjet kombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian për të përcaktuar dallimet mes të dyjave. Pas kësaj Këshilli vendos për hapjen e negociatave për kapitujt e ligjeve ku mendon se janë mjaftueshmërisht të bazuar sipas standardeve të BE. Është pikërisht kjo mundësia që vendi kandidat të bindë BE se është i aftë dhe i gatshëm të zbatojë ligjin Evropian. Kapitulli quhet i mbyllur kur të dy palët bien dakord se ai është zbatuar deri në atë masë që ju përafrohet standardeve të BE-së.

- Kap. 1** Liria e lëvizjes së mallrave;
- Kap. 2** Liria e lëvizjes së punëtorëve;
- Kap. 3** E drejta e vendosjes & liria e ofrimit të shërbimeve;
- Kap. 4** Liria e lëvizjes së kapitalit;
- Kap. 5** Prokurimi publik;
- Kap. 6** E drejta e shoqërive;
- Kap. 7** E drejta e pronësisë intelektuale;
- Kap. 8** Politika e konkurrencës;
- Kap. 9** Shërbime financiare;
- Kap. 10** Shoqëria e informacionit & media;
- Kap. 11** Bujqësia & zhvillimi rural;
- Kap. 12** Siguria ushqimore, pol. veterinare & fitosanitare;
- Kap. 13** Peshkimi ;
- Kap. 14** Politika e transportit;
- Kap. 15** Energjia;
- Kap. 16** Tatimet;
- Kap. 17** Politika ekonomike dhe monetare;
- Kap. 18** Statistikat;
- Kap. 19** Politikat sociale & punësimi;
- Kap. 20** Ndërmarrjet & politikat industriale;
- Kap. 21** Rrjetet trans-europiane;
- Kap. 22** Politika rajonale & koordinimi i instrumenteve strukturore;
- Kap. 23** Gjyqësori dhe të drejtat themelore;
- Kap. 24** Drejtësia, liria dhe siguria;
- Kap. 25** Shkenca dhe kërkimi;
- Kap. 26** Edukimi dhe kultura;
- Kap. 27** Mjedisi;
- Kap. 28** Mbrojtja e konsumatorit & shëndetit;
- Kap. 29** Bashkimi doganor;
- Kap. 30** Marrëdhëniet e jashtme;
- Kap. 31** Politika e jashtme, siguria & mbrojtja;
- Kap. 32** Kontrolli financiar;
- Kap. 33** Depozita financiare & buxhetore;
- Kap. 34** Institucionet;
- Kap. 35** Çështjet e tjera;

## 4.2 Çfarë janë Negociatat?

Hapja e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian është një proces, në të cilin vendi kandidat merr përsipër të harmonizojë legjislacionin e brendshëm me rregullat evropiane në të gjitha fushat, si dhe ta zbatojë atë. Vendi kandidat duhet të pranojë Traktatet e Themelimit dhe të Funkcionimit të BE-së.

### Palët pjesëmarrëse në negociata janë:

**Vendi kandidat** – i cili përfaqësohet nga Delegacioni Shtetëror për Negociatat;

**Vendet anëtare** – të cilat përfaqësohen nga Presidenca e Këshillit të Bashkimit Evropian.

Vendi kandidat **nuk negocion legjislacionin** (*acquis*) në vetvete, por **negocion afatet** si dhe marrjen e masave për zbatimin e legjislacionit të BE, në vendin kandidat.

**Procesi Screening** - Hapja formale e procesit të negociatave që ndiqet nga shqyrtimi analitik dhe vlerësimi i nivelit të harmonizimit të legjislacionit kombëtar me legjislacionin e BE-së. Qëllimi kryesor i **screening** është të përcaktojë ndryshimet mes legjislacionit kombëtar dhe atij të BE, për çdo kapitull. Ai është i organizuar në 2 faza:

- » *Shumëpalëshe*, ku legjislacioni i BE prezantohet nga Komisioni;
- » *Dypalëshe*, ku vendit kandidat i kërkohet të prezantojë shkallën e përafërimit me *acquis*;

Përgjatë këtij procesi, vendi kandidat duhet të jetë i gatshëm për të harmonizuar tërësisht legjislacionin e tij kombëtar me atë të BE, ose të përcaktojë fushat ku mund të kërkohet periudhë tranzitore për zbatimin e tyre. Kohëzgjatja e procesit **screening** varet nga përmbajtja e *acquis* së BE dhe varion nga një ditë deri në dy javë. Përgjithësisht, i gjithë procesi, për të 35 kapitujt e *acquis* zgjat përafërsisht një vit.

Pas këtij procesi, Komisioni European prezanton një **Raport Përfundimtar** për secilin kapitull. Mbi bazat e këtij Raporti, vendet anëtare mund të vendosin nëse do të hapen negociatat për kapitullin në fjalë, ose do të ftojë vendin kandidat që fillimisht të plotësojë të ashtuquajturat "*masat për hapjen*" ose "*masat për mbylljen*", të njohura ndryshe si **benchmarks**. Masat nënkuptojnë kushtet që duhet të plotësohen nga vendi kandidat, me qëllim hapjen e negociatave për kapitujt e veçantë.

Me hapjen e negociatave për këto kapituj, fillon faza thelbësore e procesit të negociimit. Vendi kandidat përgatit **Pozicionin Negociues** për secilin kapitull. Subjekt i negociatave janë kushtet nën të cilat vendi kandidat do të miratojë dhe zbatojë *acquis* e BE-së, përfshi dhe periudhën tranzitore. Pasi është arritur marrëveshja ndërmjet BE dhe vendit kandidat dhe pasi janë plotësuar kushtet mbyllëse, kapitulli që është trajtuar konsiderohet përkohësisht i mbyllur.

Vendimi formal merret nga **KDN (Konferenca Dypalëshe Ndërqeveritare)** në nivel ministrash. Këto negociata mund të hapen sërish:

- » Para miratimit të Traktatit të Anëtarësimit;
- » Nëse përcaktohen masa të reja; ose
- » Nëse vendi kandidat nuk i plotëson më masat përkatëse.


Në rastin kur të gjithë kapitujt janë mbyllur përkohësisht, Këshilli Evropian përcakton përfundimin e procesit të negociimit me vendin kandidat dhe rezultatet e negociatave përfshihen në masat e draftit të Traktatit të Anëtarësimit.



Pasi është arritur marrëveshja mbi tekstin e Traktatit, drafti i kalon institucioneve të BE-së dhe vendeve anëtare. Komisioni Evropian duhet të shpallë opinionin e tij përfundimtar mbi aplikimin për anëtarësim të vendit kandidat e në vijim Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian duhet gjithashtu të pranojnë aplikimin e vendit kandidat. Që nga ky moment, vendi kandidat shihet si një vend që përgatitet për të hyrë në BE.

**Traktati i Anëtarësimit** nënshkruhet nga zyrtarët më të lartë të vendeve anëtare të BE dhe vendi kandidat, e më pas ratifikohet nga të gjitha vendet anëtare. Me nënshkrimin e tij, vendi kandidat ka të drejtë të marrë pjesë si vëzhgues aktiv në punimet e Këshillit të Evropës dhe Parlamentit Evropian. Vendi kandidat bëhet vend anëtar i BE me hyrjen në fuqi të **Traktatit të Anëtarësimit**, nëse është plotësuar kushti që procesi i ratifikimit ka përfunduar.

PROCEDURA MË E SHKURTËR  
PËR HAPJEN E KAPITUVJE TË NEGOCIIMIT



### 4.3 Detyra shtëpie kolektive për Ballkanin Perëndimor dhe detyra shtëpie individuale

Nga 2014, me iniciativën e kancelares gjermane Merkel, ka nisur një seri konferencash me në qendër Ballkanin Perëndimor. Këto konferenca që mendohet të zgjatin deri në 2019, janë zhvilluar në Berlin (2014), Vjenë (2015), Paris (2016), Trieste (2017) dhe Londër (2018). Për herë të parë të gjithë drejtuesit e shteteve të rajonit takohen së bashku me drejtuesit e disa prej shteteve anëtare të BE-së dhe diskutojnë për politika dhe problemet e përbashkëta të rajonit. Gjithashtu kjo seri konferencash, e quajtur ndryshe **Procesi i Berlinit**, sjell në vëmendje bashkëpunimin rajonal në projekte të përbashkëta për qytetarët e Ballkanit Perëndimor. Kështu, Procesi i Berlinit ka ndihmuar në rënien dakord për financimin e projekteve të përbashkëta në ndërtimin e rrugëve që lidhin rajonin, në rrjet energjistik më të mirë dhe që lidhet me atë të BE-së, në shkëmbim të njohurive, të njerzve e të rinjve, në përfshirjen më të madhe të shoqërisë dhe organizatave në procesin e integritimit, të themelimit të një zone ekonomike të përbashkët ku tregtohen mallra dhe ku njerëzit lëvizin të lirë për të gjetur punë.

26

**Procesi Berlinit** i ka dhënë kështu një dimension rajonal integritimit në BE, duke i nxitur vendet e rajonit të bashkëpunojnë dhe rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet tyre, duke shkëmbyer njohuri sesi të zgjidhin probleme që janë të ngjashme për secilin vend. **Bashkëpunimi dhe marrëdhëniet e mira fqinjësore** përbëjnë gjithashtu një kusht thelbësor në Procesin e Stabilizim Asociimit dhe në anëtarësimin e këtyre vendeve, ku përmbushja e këtij kushti do të përbënte kështu një detyrë kolektive të Ballkanit Perëndimor.

Ndërkohë, përmbushja e tre kritereve të Kopenhagenit: Institucione të forta demokratike, ekonomi tregu e zhvilluar dhe përputhje e legjislacionit vendas (shqiptar) me ligjet e BE-së, mund të klasifikohen si detyra individuale drejt integritimit. Përkrah këtyre tre kushteve bazë, në bazë të progres-raporteve vjetore për secilin shtet, Bashkimi Evropian përcakton edhe prioritetet, thënë ndryshe, fushat ku shteti kandidat duhet të punojë më fort për të arritur rezultate më të mira.

## 4.4 A po i bëjmë detyrat e shtëpisë për kapitullin 23 dhe 24?

Kapitulli 23 dhe 24 janë dy kapitujt thelbësorë në përpjekjet e para-aderimit dhe janë të një rëndësie të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, ku vendosen kushtëzime strikte dhe etapa të caktuara së bashku me monitorimin nga Bashkimi Evropian. Këto janë dhe dy kapitujt të cilët duhet të hapen dhe të mbyllen të parët dhe që kanë të bëjnë me ato që jemi mësuar të dëgjojmë shpesh: forcimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Duke patur parasysh të shkuarën komuniste të Shqipërisë, por edhe të vendeve të tjera të rajonit, BE-ja ngulmon në rritjen e një kulture demokratike në këto vende nëpërmjet programeve, projekteve, financimeve dhe politikave të ndryshme. Demokracia dhe shteti i së drejtës, i pavarur nga politika, janë kushtet thelbësore për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e besimit të qytetarëve në vendin ku jetojnë.

### 4.4.1. Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Bashkimi Evropian është themeluar sipas parimeve të promovimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë dhe respektimit të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Këto parime janë të përbashkëta për të gjitha vendet anëtare dhe po ashtu edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor, veçse këto duhet edhe t'i zbatojnë parimet e demokracisë. Përsa i takon Gjyqësorit dhe të Drejtave Themelore, politikat e BE-së kanë si qëllim mbajtjen të bashkuar dhe zhvillimin e Bashkimit Evropian si një zonë e lirë, e sigurtë dhe ku zbatohet drejtësia dhe institucionet e pavaruara. Kapitulli është i strukturuar si më poshtë:

- » Sistemi gjyqësor;
- » Politikat kundër korrupsionit;
- » Të drejtat themelore;

Një gjyqësor i pavarur dhe i paanshëm përbën kushtin kryesor të këtij kapitulli. Reforma në drejtësi po fillon të sjellë ndryshimet e para që nga miratimi i saj në korrik 2016. Fenomene të tilla si korrupsioni, mungesa e profesionalizmit, efiçencës, transparencës apo pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve kanë ulur ndjeshëm besimin e publikut në institucionet



e drejtësisë. Reforma tashmë ka nisur të sjellë ndryshimin e situatës së sistemit të drejtësisë në vend. Një prioritet shumë i rëndësishëm, i cili ka qenë dhe pjesë e progres-raportit të 2016 janë mbrojtja dhe respektimi i të drejtave themelore. Tashmë në kuadër të reformës shumë ligje kanë ndryshuar, por ajo që mbetet ende në diskutim është zbatimi i tyre në praktikë.

Të drejtat themelore, si pjesë e këtij kapitulli theksojnë faktin se legjislacioni shqiptar është thujse i njëjtë me atë të BE-së dhe traktateve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, megjithatë, nuk ka zbatim të këtyre ligjeve. Edhe pse nga ana teknike ky kapitull mund të miratohet lehtë, për disa vite me radhë, Komisioni Evropian thekson se Shqipëria duhet të zbatojë ligjet për të drejtat e njeriut si: një media e lirë, zgjedhje të lira, shanse të barabarta mes grave dhe burrave, lehtësira dhe shërbime për njerëzit me aftësi të kufizuara, organizimi i protestave paqësore etj.

#### 4.4.2. Kapitulli 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria

Politikat e BE-së kanë për qëllim të zhvillojnë BE-në si një zonë të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Kapitulli është i strukturuar si më poshtë:

- » Kufijtë e jashtëm;
- » Migracioni;
- » Politika e vizave;
- » Azili;
- » Bashkëpunimi policor dhe lufta kundër krimit të organizuar;
- » Lufta kundër terrorizmit;
- » Bashkëpunimi në fushën e luftës kundër drogës;
- » Sistemi doganor;
- » Bashkëpunimi gjyqësor në çështje civile dhe penale;

Një nga problematikat që vendi ynë has në kuadër të këtij kapitulli ka qenë largimi i shqiptarëve si azilkërkues drejt vendeve të BE-së dhe veçanërisht Gjermanisë e së fundmi drejt Francës. Kapitulli 24 është i një rëndësie të veçantë për Shqipërinë dhe BE-në. Shqipëria duhet të shtojë dedikimin dhe efikasitetin e luftës kundër korrupsionit dhe drogës duke bashkëpunuar më shumë me institucionet dhe agjensitë e BE-së. Gjithashtu, Shqipëria duhet të marrë shumë shpejt masa për të ndaluar emigracionin e parregullt të qytetarëve të saj drejt shteteve anëtare të BE-së. Shumë të rinj kërkojnë azil në Francë dhe Angli, për një të ardhme më të mirë. Ndërkohë këta të rinj janë kthyer mbrapsht pasi Shqipëria konsiderohet si një vend i sigurt origjine. Për rrjedhojë, shteti duhet të përmirësojë cilësinë në edukimin e të rinjve dhe krijimin e vendeve të reja të punës me qëllim uljen e fluksit të emigrimit jashtë vendit, të forcës më të madhe punëtore. Një fenomen që vihet re është dhe "largimi i trurit" pikërisht ajo shtresë e popullsisë që ofron shërbime dhe ndihmon një vend të ecë përpara. Ky është një kapitull me të cilin vendi ynë duhet të punojë fort jo vetëm për përmbushur kriteret që kërkohen, por për t'u bërë një vend i lirë dhe i sigurt për qytetarët e saj, ashtu siç është BE-ja për qytetarët evropianë.

## SHQIPTAR DHE EVROPIAN

### 5.1 Kontributi qytetar në jetën e përditshme në procesin e integritimit

Qytetarët e Shqipërisë, por edhe të çdo vendi që kërkon të anëtarësohet, janë hallka kryesore e shtyrjes përpara të procesit të integritimit. Anëtarësimi në një organizatë më të madhe si Bashkimi Evropian, vjen me përfitime të mëdha, por edhe me detyra e përgjegjësi të mëdha. Ndaj është e rëndësishme që ky proces të kuptohet nga qytetarët, e gjithësecili të japë kontributin e tij/saj.

30

Sfidat Drejt Integritimit

Nëpërmjet informimit dhe kuptimit të tërë procesit, qytetarët shqiptarë duhet të jenë të aftë të kuptojnë dokumenta me rëndësi të veçantë të Komisionit Evropian si Progres Raportet apo Strategjitë e Zgjerimit. Duke kuptuar këto dokumenta, qytetarët janë të aftë të ushtrojnë presion mbi qeverinë apo parlamentin që të përmirësojnë punën e tyre në fusha të caktuara siç përmenden në këto dokumenta.

Gjithashtu këto dokumenta shërbejnë si **vlerësime të drejta** të situatës së jetës së qytetarëve për të drejtat e njeriut, ekonominë, shërbimet publike, mjedisin etj. Dokumente si Strategjitë, Raportet por edhe të tjera japin shumë informacione mbi mundësitë direkte që kanë individët të përfitojnë nga përparimi i vendit në rrugën e integritimit. Për shembull vendet e Ballkanit Perëndimor mund të përfitojnë nga shkëmbimet **Erasmus** kudo në Evropë, mund të marrin fonde për punë kërkimore, nëse shteti ka status kandidat mund edhe të aplikojnë për praktika pune pranë institucioneve të BE-së etj.



Kushtet dhe reformat e kërkuara nga BE-ja **duhen zbatuar në themel**, duke ngritur një kulturë tek njerëzit dhe në institucione mbi vlerat demokratike. Ato nuk duhen parë si një listë për t'u përmbushur pa bërë ndryshime në mënyrën e qeverisjes, në konceptimin e funksionimit të institucioneve si të pavarura nga njëra-tjetra, apo pa kultivuar edukimin qytetar që në shkolla për funksionimin e një shteti demokratik. Për këtë arsye, është e nevojshme që nxënësit, studentët dhe qytetarët e rinj e të vjetër të shoqërisë sonë, të kuptojnë mekanizmat e shtetit, i cili funksionon në shërbim të qytetarit dhe nevojave të tij.

Thuhet vazhdimisht se Bashkimi Evropian, po ashtu edhe procesi i integritimit kuptohet pak nga qytetarët. Gjithashtu, investimet dhe kushtet e BE-së shikohen si të lidhura ngushtë me politikën, por jo me qytetarin. Kjo broshurë shërben si një manual për të kuptuar më mirë BE-në, procesin e integritimit dhe ecjen e Shqipërisë përgjatë kësaj rruge. Si qytetarë evropianë, edhe qytetarë shqiptarë, ne duhet të dimë më tepër e të jemi pjesë më aktive në përmirësimin e Shqipërisë drejt rrugës së integritimit.

# BIBLIOGRAFI

- Balfour, Rosa & Corina Stratulat (eds.), "EU Member States and Enlargement towards the Balkans", *EPC Issue Paper*, no. 79, Brussels, July 2015, pp. 223-235, [http://www.epc.eu/pub\\_details.php?cat\\_id=2&pub\\_id=5832](http://www.epc.eu/pub_details.php?cat_id=2&pub_id=5832), retrieved 18 December 2017.
- Berlin Process 2014-2018*, Cooperation and Development Institute, EU integration, Berlin Process Series Publication, Tirana, March 2018.
- Competences of the EU and European Commission*, European Commission Webpage, retrieved January 2018, <http://ec.europa.eu/citizens-initiative/public/competences/faq>.
- Friis, Lykke & Anna Murphy, "Turbo-Charged Negotiations: The EU and the Stability Pact for South Eastern Europe", *Journal of European Public Policy*, vol. 7, no. 5, 2000.
- Gero R., Pejovic A.A., Kusi S., Kust M., (2016). Manual mbi procesin e negociatave të anëtarësimit në BE (Eksperienca e Kroacisë dhe Malit të Zi); Tiranë: Ministria e Integritimit Evropian; SMEI III; FINEUROP Support.
- Grabbe, Heather *et al.*, "Beyond Wait-and-See: the Way Forward for EU Balkan Policy", *European Council on Foreign Relations Policy Brief*, London, May 2010, [http://ecfr.eu/page/-/ECFR21\\_BALKAN\\_BRIEF.pdf](http://ecfr.eu/page/-/ECFR21_BALKAN_BRIEF.pdf), retrieved 18 December 2017.
- <https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/6f-cdb304-b542-11e7-837e-01aa75ed71a1/language-en/format-PDF/source-50252916>
- İçener, Erhan & David Pinnemore, "Building on Experience? EU Enlargement and Western Balkans", in Soeren Keil & Zeynep Arkan (eds.), *The EU and Member State Building*, Abingdon, Routledge, 2015.
- Independent Analysis and Follow up of EU Accession Progress Report of Albania, Institute for Democracy and Mediation, Tirana, 2015.
- Llubani M., (2014). Perspektiva Evropiane e Shqipërisë: Perceptime dhe Relatete 2014. Tiranë: FES & Albanian Institute for International Studies
- Malaj, A., Maho, A., Tepelia. A., (2016). Antaresimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian; Manual për qytetarët. Tiranë: FES & Shoqëria e Hapur për Shqipërinë & EU Info Network
- Pinnemore, David, "Stabilisation and Association Agreements: Europe Agreements for the Western Balkans?", *European Foreign Affairs Review*, vol. 8, no. 1, 2003.
- Pinnemore, David, "The Stabilization and Association Process: a Framework for European Union Enlargement?", in Arolda Elbasani (ed.), *European Integration and Transformation in the Western Balkans: Europeanization or Business as Usual*, London, Routledge, 2013.
- Pippan, Christian, "The Rocky Road to Europe: the EU's Stabilisation and Association Process for the Western Balkans and the Principle of Conditionality", *European Foreign Affairs Review*, vol. 9, no. 2, 2004.
- Shadow Report on Political Copenhagen criteria in Western Balkans EU Candidate States*, EU-RS Think Tank, Belgrade, December 2017.
- Xhepa I., Kodra K., (2014). Unë dhe Europa. Tiranë: Qendra Evropiane.